


2.3 STUKO PËR MBUSHJEN E FUGAVE 2 KOMPONENTËSH

FUGAFLEX



| Njësia matëse | copë/paletë | Konsumi |
|---------------|-----------------|-------------------------|
| 2 kg/kovë | 120 copë/paletë | 0.2-1 kg/m ² |



FUGAFLEX

Material dy komponentësh. Komponenti A në formë pluhuri me bazë çimento, guri natyror rezina sintetike dhe pigmente special, si dhe komponenti B në formë lëngu me bazë elastomerike për rezistencë më të lartë në shtypje dhe përkulje si edhe rezistencë ndaj agjentëve kimike dhe detergjentëve larës.

PËRGATITJA E FUGAVE

Sipërfaqja e mbuluar me pllaka dhe hapësirat midis tyre duhet të jenë plotësisht të pastra. Nëse ngjitja e pllakave është realizuar me ngjitës, mbushja e fugave në mure bëhet mbas 8 – 12 orësh; mbushja e fugave në dysheme bëhet mbas 12 - 24 orësh. Nëse ngjitja e pllakave është realizuar me llaç tradicional ose të parapërgatitur me bazë çimento, mbushja e fugave në mure bëhet mbas 2 - 3 ditësh ndërsa mbushja e fugave në dysheme bëhet mbas 8 - 10 ditësh.

PËRGATITJA E PËRZIERJES

Përzieni fillimisht 200 gr komponent B me 300 - 500 ml ujë të pastër dhe më pas shtoni komponentin A në formë pluhuri. Përziera realizohet me një mikser me xhiro të ngadalta 200 – 300 rrotullime në minutë derisa të formojë një masë homogjene dhe pa kokrriza. Më pas lihet në qetësi për 5 minuta dhe përzihet edhe një minute tjetër para përdorimit. Në këtë mënyre produkti është i gatshëm për përdorim.

MËNYRA E PËRDORIMIT

Fugat mbushen me mbushës me anën e një spatule të butë gome. Mbushësi i tëpërt mund të hiqet nëpërmjet një sfungjeri të njomë kur Fugaflex 0 - 5 mm të këtë arritur fortësinë e mjaftueshme (zakonisht 15 - 20 minuta pas aplikimit). Pastrimi i mureve apo i dyshemeve realizohet nëpërmjet një lecke të thatë apo një cope të leshtë kur mbushësi të jetë forcuar plotësisht, pastrimi mund të bëhet edhe një ditë me vonë mbas aplikimit të mbushësit për fuga.

TEMPERATURA E APLIKIMIT

Fugaflex 0 - 5 mm rekomandohet të aplikohet në temperaturë nga +5°C në +35°C.

PËRGATITJA E FUGAVE

Sipërfaqja e mbuluar me pllaka dhe hapësirat midis tyre duhet të jenë plotësisht të pastra përpara aplikimit të produktit. Nëqoftëse shtrimi i pllakave është bërë me ngjitës, mbushja e fugave në mure duhet të bëhet mbas 4 - 8 orësh. Mbushja e fugave në dysheme bëhet mbas 24 - 36 orësh. Nëse shtrimi i pllakave është bërë me llaç tradicional, mbushja e fugave në mure rekomandohet të bëhet mbas 2 - 3 ditësh, mbushja e fugave në dysheme rekomandohet të bëhet mbas 8 - 10 ditësh.





TE DHËNA TEKNIKE (NË 23°C DHE 50% U.R)

| | |
|-----------------------------|--|
| Forma Komponenti A | Pluhur |
| Forma Komponenti B | Lëng |
| Ngjyra Komponenti A | Shih tabelën e ngjyrave, i disponueshëm në 30 ngjyra |
| Ngjyra Komponenti B | |
| Ruajtja | 24 muaj në paketim original në vend të thatë |
| Djegshmëria | I padjegshëm |
| Raporti i përzierjes | Aditiv + 500 gr ujë për kovë |
| Dendësia e përzierjes | 2 gr/cm ³ |
| pH i përzierjes | 12 |
| Konsistenca e përzierjes | Pastë e rrjedhshme |
| Temperatura e aplikimit | +5°C deri +35°C |
| Kohëzgjatja e përzierjes | 2 orë |
| Kalueshmëria | Pas 24 orësh |
| Mbushja e fugave në mure | pas 8 deri 12 orësh |
| Mbushja e fugave në dysheme | pas 24 deri 36 orësh |



TË DHËNA PËRFUNDIMATARE

| | |
|---|------------------------|
| Rezistenca ndaj lagështisë | Shumë e mirë |
| Rezistenca ndaj tretësirave dhe vajrave | Shumë e mirë |
| Rezistenca në shtypje | ≥ 30 N/mm ² |
| Rezistenca në përkulje | ≥ 10 N/mm ² |